

SYLLABUS Letërsi për fëmijë

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike: Programi:	Fakulteti i Filologjisë Gjuhë shqipe
Titulli i lëndës:	Letërsi për fëmijë
Niveli:	Trevjeçar
Statusi lëndës:	obligativ
Viti i studimeve:	Viti III
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Sem.5
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. as. dr. Xhevat Syla
Detajet kontaktuese:	xhsyla@yahoo.com, tel. 044 127 506
Përshkrimi i lëndës	Programi i lëndës Letërsi për fëmijë si lëndë në nivelin universitar ka për qëllim t'i njohë studentët e programit parashkollor me letërsinë për fëmijë si fushë specifike e letërsisë në përgjithësi, si dhe me autorë e vepra që bëjnë vlerat kulminante të saj. Duke u njohur me vepra të zgjedhura të autorëve të shquar shqiptarë të letërsisë për fëmijë, studentët do t'i çojnë më tej njohuritë për llojet letrare për fëmijë dhe do të aftësohen për bartjen e këtyre njohurive të fëmijët, por edhe të mësimdhënësit e ardhshëm, duke aplikuar metodologji, strategji, parime, kritere, teknika e forma të punës që lidhen me punën me fëmijët e moshës shkollore, por edhe me mësimdhënien e letërsisë në shkollë.
Qëllimet e lëndës:	Letërsia për fëmijë synon të aftësojë profesionalisht studentët e profilit fillor për punë të sukseshme dhe efektive në institucionet shkollore, por edhe për mësimdhënie bashkëkohore, duke ua bërë të ditur vizionin e mundësive metodologjike në kuadër të njohjes dhe përdorimit të parimeve, kritereve, metodave, teknikave, formave dhe strategjive që lidhen me punën me fëmijët, me të nxënit nga ana e tyre, si dhe me vlerësimin e aftësimit të tyre etj. Në këtë kurs apo cikël ligjëratah studentët do të njihen me zhvillimin historik të letërsisë për fëmijë të ne, me rolin që ajo pati dhe ka për formimin e fëmijës, për formimin e shijes estetike të tyre, si dhe për qëllimet e saj mësimore, argëtuese dhe edukative.

Rezultatet e pritura të nxënies:	Të njohin historikun e zhvillimit të letërsisë shqipe për fëmijë, specifikat dhe vlerat me të rëndësishme të saj, duke u aftësuar për vlerësimin dhe interpretimin e tyre në kuadër të dijeve teorike dhe të mësimdhënies bashkëkohëse të letërsisë, të krahasojnë teoritë e të mësuarit duke argumentuar përparësitë e njërës kundrejt tjetrës; të shprehin bindjet e tyre lidhur me teorinë më të përshtatshme për punë me më të vegjlit dhe për mësimdhënien dhe të nxënit në shkollën tonë; të dallojnë metoda, forma, strategji dhe teknika që nxisin një punë më të sukseshme me fëmijët, ku do të përdorin metodat që nxisin mendimin kritik, interpretimin e tekstit letrar, të nxënit në bashkëveprim etj. Studentët do të mund të bëjnë dallimin e zhanreve letrare për fëmijë, të figuracionit letrar, si dhe të nxjerrin me sukses mesazhin e veprave letrare.
Metodologjia e mësimdhënies:	<i>Mësim i rregullt me disa qasje intensive ndërvepruese, duke përdorur format më praktike në mënyrë që studentët të kuptojnë lëndën, vlerat, mesazhet dhe artin letrar. Diskutimi i problemeve, stili i mësimdhënies, format e punës: frontale, grupore, individuale, të praktikës, seminarike, edhe ndonjë formë tjetër, si mësimi projekt etj. Përvç ligjërava, ushtrimeve dhe eseve, do të bëhet edhe interpretimi i veprave nga ana e studentëve, të cilët do t'i lexojnë ato. Me qëllim të aftësimit për punë më të sukseshme me fëmijët, do të praktikohet edhe ushtrimi i leximit me zë i krijimeve të ndryshme letrare, duke kultivuar këhtu leximin artistik dhe motivues.</i>

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Ligjërata	26	8	13
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	6	2	
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	35	7	
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	10	2	
Kollokfiume, seminare, projektet, prezentimet, etj	5	2	

Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	10	3	
Përgaditja përfundimtare për provim	40	7	
Totali	126	31	13
Metodat e vlerësimit:	Pjesëmarrje dhe angazhim-deri në 10 % Kontroll i pjesshëm I – 20 % (praktika mësimore, portofolia) Kontroll i pjesshëm II – 20% (punime seminarike, modele të njësive mësimore) Provimi përfundimtar – 50% Pjesëmarrja në diskutime, në projekte dhe modele të interpretimit të teksteve letrare.		
Literatura			
Literatura bazë:	<i>1.Prof. as. Dr. Astrit Bishqemi, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj, Elbasan 2008; Prof. as. Dr. Astrit Bishqemi, Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë, Sejko, Elbasan 2004, Prof. as. Dr. Astrit Bishqemi, Histori e letërsisë botërore për fëmijë, Sejko, Elbasan 2006, Prof. Bedri Dedja, Burime të letërsisë shqipe për fëmijë, Rilindja, Prishtinë 1977; Dr. Agim Deva, Poezia shqipe për fëmijë 1872-1980, Rilindja, Prishtinë 1982; Agim Deva, Romani ynë për fëmijë, Rilindja, Prishtinë 1977; Odhise Grillo, Leksikoni i shkrimtarëve shqiptarë për fëmijë, Tiranë 2002; Prof. As. Dr. Ramazan Çadri, Lindja dhe formimi i letërsisë shqipe për fëmijë, Dodona, Tiranë 2009;</i>		
Literatura shtesë:	<i>Tasim Gjokutaj, Letërsia për fëmijë, Toena, Tiranë 2007; Bardhosh Gaçe, Letërsia për fëmijë; Xhevat Syla, Kush e shkruan poezinë- vlerësime për letërsinë për fëmijë, Libri Shkollor, Prishtinë 2005; Xhevat Syla, Kuvendim poetik – antologji e poezisë shqipe për fëmijë e të rinj, Libri Shkollor, Prishtinë 2010, Odhise Grillo, Panoramë letrare I, II, III, Tiranë, 1986, 1998, 2000; Prof.sc. Faik Shkodra, Letërsi për fëmijë, Universiteti i Prishtinës, 2002,; Qibrije Demiri, Letërsi për fëmijë, Rozafa, Prishtinë 2011</i>		

Plani i detajuar i mësimi:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java e parë:	<p>Nocioni Letërsia për fëmijë; Burimet e letërsisë shqipe për fëmijë; letërsia për fëmijë dhe ajo për të rritur – përkimet dhe dallimet; Specifikat e letërsisë për fëmijë; Periodizimi dhe studimi i letërsisë shqipe për fëmijë</p> <p>Literatura: Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, <i>Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj</i>, Sejko, Elbasan 2008; Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, <i>Hyrje në teorinë e letërsisë për fëmijë</i>, Sejko, Elbasan 2004</p>
Java e dytë:	<p>Letërsia botërore për fëmijë në vitet 1900, përkthimi në gjuhën shqipe dhe ndikimi i saj në letërsinë shqipe për fëmijë</p> <p>Literatura: Prof.ass.dr. Astrit Bishqemi, <i>Histori e letërsisë botërore për fëmijë, sejko, Elbasan 2006</i></p>
Java e tretë:	<p>Fillimet e letërsisë shqipe për fëmijë, veprat didaktike të shek. XVI-XVIII dhe autorë të Rilindjes kombëtare që krijuan për fëmijë</p> <p>Konstantin Kristoforidhi dhe krijimtaria e tij letrare për fëmijë, Sami Frashëri, (Dheu është flori)</p> <p>Literatura: Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, <i>Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj</i>, Sejko, Elbasan 2008</p>
Java e katërt:	<p>Krijimtaria për fëmijë e Naim Frashërit</p> <p>Ndre Mjeda – motivi i shkollës dhe ai social në poezinë për fëmijë</p> <p>Literatura: Agim Deva, <i>Poezia shqipe për fëmijë 1872-1980, Rilindja, Prishtinë 1982</i>; Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, <i>Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj</i>, Sejko, Elbasan 2008</p>
Java e pestë:	<p>Rexhep Hoxha (Zogu i qiellit, Lugjet e verdha) – Përralla në romanin për fëmijë</p> <p>Mark Krasniqi (Vjersha të zgjedhura për fëmijë, Mos fol gojë pa nevojë) Gërshetimi i letërsisë gojore dhe asaj artistike</p> <p>Literatura: Agim Deva, <i>Poezia shqipe për fëmijë 1872-1980, Rilindja, Prishtinë 1982</i>; Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, <i>Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj</i>, Sejko, Elbasan 2008</p>
Java e gjashtë:	Bedri Dedja dhe kontributi i dhënë letërsisë për fëmijë

	<p>(Përralla popullore mbi kafshët, Qyteti m,e tri kështjella) Relacioni midis reales dhe fantastikes Literatura: Agim Deva, <i>Poezia shqipe për fëmijë 1872-1980, Rilindja, Prishtinë 1982; Xhevat Syla, Kush e shkruan poezinë, Faik Konica, Prishtinë 2005</i></p>
Java e shtatë:	<p>Odhise Grillo (Mollëkuqja e fëmijërisë, Përrallat, Përshtatjet e veprave të njohura nga letërsia botërore dhe ajo kombëtare për fëmijët) Litertura: Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, <i>Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj, Sejko, Elbasan 2008</i></p>
Java e tetë:	<p>Xhevat Beqaraj (Kam një harmonikjë) Gaqo Bushaka (Legjenda e kalorësit të Skënderbeut) Historia dhe letërsia për fëmijë Literatura: Xhevat Syla, <i>Harmonika e atdhut, Faik Konica, Prishtinë 2005, Xhevat Syla, Kush e shkruan poezinë, Faik Konica, Prishtinë 2005</i></p>
Java e nëntë:	<p>Qamil Batalli (Agimet e kaltra – roman i aktualitetit) Rifat Kukaj (Një verë pa bukureza, Gjurmë me lule) Lufta në romanin tonë për fëmijë Literatura: Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, <i>Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj, Sejko, Elbasan 2008; Xhevat Syla, Kush e shkruan poezinë, Faik Konica, Prishtinë 2005</i></p>
Java e dhjetë:	<p>Vehbi Kikaj (Sarajet e bardha, roman realist) Vepra poetike për fëmijë e Ismail Kadaresë (Princesha Argjiro, Kështjella dhe helmi) Poema dhe drama për fëmijë Literatura: Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, <i>Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj, Sejko, Elbasan 2008; Xhevat Syla, Arti i porosisë, Libri shkollor, Prishtinë 1998</i></p>
Java e njëmbëdhjetë:	<p>Ali Huruglica (Vjersha të zgjedhura për fëmijë) Qasja moderne temave dhe motiveve te njohura Gjëegjëza e kultivuar (Odhise Grillo, Adelina Mamaqi, Arif Demolli, Abdullah Thaçi) dhe rëndësia e saj për fëmijët e moshës më të re Literatura: Agim Deva, <i>Poezia shqipe për fëmijë 1872-1980, Rilindja, Prishtinë 1982; Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj, Sejko, Elbasan 2008</i></p>
Java e dymbëdhjetë:	<p>Rrahman Dedaj (Zogu dhe kulla) Poetika e tregimit për fëmijë Fejzi Bojku (Ngjyrat e qiellit tim, Tungjatjeta vjeshtë, Çfarë i falëm ditës) Literatura: Prof, ass. Dr. Astrit Bishqemi, <i>Historia e letërsisë</i></p>

	<i>shqiptare për fëmijë e të rinj, Sejko, Elbasan 2008; Kompleti i veprave të Rrahman Dedajt, vëllimi IV, parathënia e Xhevat Sylës, Fak Konica, Prishtinë 2008</i>
Java e trembëdhjetë:	Ymer Elshani (Aventurat mbi trotinetin e vjetër ose Njohja e trimave, Gjelastreni mendjelehtë) Mesazhi human i poezisë , tregimeve e romaneve dhe fati tragjik i autorit Literatura: <i>Xhevat Sylë, Universi i mirësisë, jeta dhe vepra e Ymer Elshanit, Libri shkollor, Prishtinë 2009</i>
Java e katërbëdhjetë:	Agim Deva (Vjersha të zgjedhura për fëmijë, Guri rrokulliset për pjetë, Koha e luleve / Loja, poezia sociale, aktualiteti, tema ekologjike) Literatura: <i>Prof. ass. Dr. Astrit Bishqemi, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë e të rinj, Sejko, Elbasan 2008</i>
Java e pesëmbëdhjetë:	Test Abdullah Thaçi (Përralla nga Prevala) Arif Demolli (Lushi si askushi) Literatura: <i>Prof. Ass. Dr. Astrit Bishqemi, Historia e letërsisë shqiptare për fëmijë dhe të rinj, Sejko, Elbasan 2008</i>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Studentët duhet t'u përbahen rregullave të përcaktuara sipas Statutit të UP-së dhe rreulloreve dhe vendimeve të miratuara nga Senati I UP-së dhe këshilli mësimor I FE.